



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

21.5.2024, Prishtinë

Shpallje për aplikim

Bazuar në vendimin Nr. 2583/224 për Shpalljen publike të datës 13.5.2024, të publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për thirrjen publike për projekt-propozime nga organizatat jo qeveritare, me titull: THIRRJE PËR ORGANIZATA JO-QEVERITARE PËR ZBATIMIN 3-VJEÇAR TË PROGRAMIT “REHABILITIMI PËR TË RINJTË”, ftojmë organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e anëtarit/res:

- Një përfaqësues/e nga OJQ-të, që kanë përvojë në me përvojë nga lëmi i edukimit dhe promovimit shëndetësor, si dhe të ofrimit të shërbimeve të rehabilitimit shëndetësor për të rinjtë.

- Një përfaqësues/e nga shoqëria civile, në cilësinë e ekspertit, me përvojë nga lëmi i edukimit dhe promovimit shëndetësor, si dhe të ofrimit të shërbimeve të rehabilitimit shëndetësor për të rinjtë.

Përfaqësuesit e lartcekur, do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve nga thirrja publike e theksuar më lartë.

Të dy anëtarët duhet të mbështesin me dëshmi shtesë kapacitetin e tyre në fushën e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, fushën e rehabilitimit të të rinjve me probleme të shëndetit mendor, e po ashtu edhe në analizimin dhe vlerësimin e projekt-propozimeve.

Nuk pranohet që aplikuesi/sja të ketë konflikt interesi me OJQ-të që do të mund të përzgjidhen. Në një rast të tillë anëtari/rja duhet të deklarohet me shkrim dhe Komisioni do ta zëvendësoj atë me anëtarin rezervë.

Afati për aplikim është deri me datë, 28.5.2024, ora 16.00. CV-të, certifikatat, diplomatat dhe dëshmitë tjera mbështetëse duhet të dërgohen në e-mail adresën si vijon: dep.rinia@gmail.com Titulli në subjekt të shkruhet për pozitën anëtar i komisionit për vlerësimin e projekteve të programit: “THIRRJE PËR ORGANIZATA JO-QEVERITARE PËR ZBATIMIN 3-VJEÇAR TË PROGRAMIT “REHABILITIMI PËR TË RINJTË”.